



Prishtinë, 13.05.2024
Kodi i ZRRE-së: V_2015_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2520_04_24** i datës 02.04.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 07.02.2024.

në seancën e mbajtur më datë **13.05.2024** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H.SH nga Komuna e Obiliqit ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2520_04_24 i datës 02.04.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 02.04.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2520_04_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës i kishte kontestuar faturat e energjisë elektrike, me njehsorin elektrik nr. 69676552 për shkak të dyshimit në lexim dhe faturim jo të saktë.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori H.SH brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
-

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 13.05.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 07.02.2024; Vendimin e DMK të datës 02.04.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës



02.12.2022; Përgjigjën e KESCO-s të datës 06.09.2023, Ankesën e konsumatorit në DMK ZRrE-së të datës 07.02.2024; Procesverbalin e inspektimit të dt. 29.08.2023; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 29.08.2023; Protokollin e verifikimit të njehsorit elektrik – mekanik në QK, i dt. 29.09.2023; Raporti mbi Kontrollimin – Pranimin e grupit matës i dt. 26.03.2018; Rrjedhën e energjisë elektrike dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Me datë 29.08.2023, punëtorët e autorizuar të KEDS e kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar që gjithçka është në rregull dhe se njehsori furnizon saktë këtë konsumator. Në të njëjtën ditë, konsumatorit i ishte ndërruar njehsori dhe për matje ishte vendosur njehsori i ri me nr. 87434007, me gjendje të shpenzimeve 000 kWh dhe njehsori i vjetër me nr. 96976552 është dërguar për verifikim në QK.

Bordi ka analizuar me kujdes Protokollin e Verifikimit të njehsorit elektrik me nr. 8720 dhe ka gjetur se 29.09.2023 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr. 69676552 me gjendje TL=45761 kWh dhe TU=15059 kWh si dhe kanë konstatuar se: njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka, kurse gabimi ne matje është **+0.54%**. Bordi ka shqyrtuar te dhënat e evidentuar ne procesverbal dhe konstaton se gabimi ne matje është brenda kufijve te lejuar te matjes te përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH e qe është +-2.5%.

Bordi po ashtu ka gjetur se, me kërkesë të DMK-së me datë 14.03.2018 ka kërkuar nga KESCO/KEDS qe te behet shqyrtimi i saktësisë se matjes për njehsorin nr. 69676552 me pajisje te dorës "ZERA". Bazuar ne kërkesën e DMK ne ZRRE, ekipet e autorizuar te KEDS-it me date 26.03.2018 kane bere inspektimin si dhe shqyrtimin e saktësisë së pikës matëse dhe se bazuar ne shqyrtimin e bere ka rezultuar se gabimi ne matje ka qenë -0.90% e qe kjo vërteton se matja e njehsorit ka qenë brenda kufijve te lejuar edhe me kodin e Matjes se OSSH. Po ashtu vërehet se konsumatori ka qenë i pranishëm ne momentin e shqyrtimit pasi qe edhe ka nënshkruar pranimin e procesverbalit.

Më tej Bordi ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori ka lexime te sakte të shpenzimeve mujore, përkatësisht lexuesi i KEDS-it ne asnjë rast nuk ka evidentuar se nuk ka qasje ne leximin e shpenzimeve mujore apo qe dyshon se njehsori elektrik nuk bene matje te sakte. DMK po ashtu ka bere krahasimin e shpenzimeve per periudha te njëjta kohore me tre njehsorët elektrik, njehsorin elektrik nr. 62260380, njehsorin e vjetër/kontestues nr. 69676552 dhe njehsorin e ri elektrik nr.87434007 dhe konstaton se konsumatori ne periudha te ndryshme ka ndryshime ne shpenzim te energjisë elektrike. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 62260380 per periudhat: periudhën 10/2017 është 679 kWh, 11/2017 është 565 kWh, 12/2017 është 595 kWh, 01/2018 është 854 kWh, 02/2018 është 1,077 kWh, 03/2018 është 937 kWh, 10/2018 është 1,067 kWh, 11/2018 është 1,219 kWh dhe 12/2018 është 1,192 kWh, me njehsorin kontestues nr. 69676552 periudhat: 10/2019 është 1,227 kWh, 11/2019 është 1,193 kWh, 12/2019 është 1,428 kWh, 01/2020 është 1,352 kWh, 02/2020 është 1,329 kWh, 03/2020 është 1,445 kWh, 10/2020 është 549 kWh, 11/2020 është 1,001 kWh(per këtë periudhe po ashtu është faturuar edhe me 1,355 kWh per shkak se ka pasur te vendosur njehsorin nr. 13544285), 12/2020 është 1,228 kWh,



01/2021 është 1,324 kWh, 02/2021 është 1,214 kWh, 03/2021 është 1,213 kWh, 10/2021 është 1,177 kWh, 11/2021 është 1,198 kWh, 12/2021 është 1,424 kWh, 01/2022 është 1,290 kWh, 02/2022 është 958 kWh, 03/2022 është 789 kWh, 10/2022 është 1,001 kWh, 11/2022 është 1,071 kWh, 12/2022 është 839 kWh, 01/2023 është 910 kWh, 02/2023 është 1,059 kWh dhe 03/2023 është 1,036 kWh kurse me njehsorin e ri nr.87434007 periudhat: 10/2023 është 938 kWh, 11/2023 është 686 kWh, 12/2023 është 569 kWh , 01/2024 është 568 kWh, 02/2024 është 646 kWh dhe 03/2024 është 702 kWh.

Kwsisoj, Bordi ka shqyrtuar te gjitha procesverbalet e lartë përmendura e ne veçanti edhe dy procesverbalet e shqyrtimit te saktësisë se matjes dhe konstaton se ne asnjë rast nuk është evidentuar se njehsorët elektrik nuk janë jashtë kufijve te lejuar te matjes, andaj edhe konstaton se faturimi dhe matja e njehsorit kontestues është i saktë dhe se faturimi është ne përputhje me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifatat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. Po ashtu duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me energji elektrike - të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, “Të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifatat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”, andaj, konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **H.SH** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.